



Udhëzimet me shkrim për çështjet dhe procedurat e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve sipas LIGJI Nr. 06/L -085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE dhe POLITIKËS SË AFK-së PËR SINJALIZIM

AFK-ja përmes materialit vijues i shpalos udhëzimet e nevojshme me shkrim lidhur me çështjet dhe procedurat e sinjalizimit apo thënë ndryshe, raportimit për shkeljet që çënojnë apo dëmtojnë interesin e përgjithshëm apo interesin publik në kuadër të AFK-së.

Këto udhëzime përditësohen rregullisht dhe përveç publikimit në uebfaqen zyrtare të AFK-së të njëjtat transmetohen përshtatshëmrisht edhe tek stafi I AFK-së.

Udhëzimet për çështjet më të rëndësishme rreth sinjalizimit janë paraqitur si vijojnë:

Çfarë nënkupton sinjalizimi?

Sinjalizimi është raportimi që bëhet në AFK, ndaj shkeljeve apo keqpërdorimeve që konsiderohen që kërcënojnë, çënojnë apo dëmtojnë interesin e përgjithshëm të AFK-së dhe atë publik, të shkaktuara nga veprimet apo mosveprimet e punonjësve të AFK-së në kuadër të marrëdhënies së punës në AFK. Për më shumë, në vijim do të shihni së çka është sinjalizuesi, kush mund të jetë sinjalizues, çka, si kur dhe te kush mund të sinjalizoni dhe gjëra të tjera të nevojshme që ndërlidhen me sinjalizimin.

Çka është sinjalizuesi ?

Sinjalizuesi është çdo person i cili raporton ose sinjalizon informacione për një kërcënim ose cenim të interesit të përgjithshëm në/apo AFK në kontekstin e marrëdhënies së punës në AFK.

Çka nënkupton person sinjalizues në kontekst të marrëdhënies së punës?

Nënkupton personin fizik i cili është apo ka qenë në marrëdhënie pune pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, kohëzgjatja ose pagesa;

- bashkëpunëtor i jashtëm ose i rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim;
- kandidat për punësim, aktivitete vullnetare, praktikë profesionale ose trajnim;

- në marrëdhënie kontraktore punësh, shërbimesh ose lloje të tjera bashkëpunimi apo përdorim i shërbimeve të institucionit, përfshirë kontraktimin ose nënkontraktimin.

Çka nënkupton interesi I përgjithshëm në AFK dhe ai publik?

Interesi I përgjithshëm , në kuptim më të gjerë, përfshin vlerat e përgjithshme të AFK-së, si misionin, qëllimin, imazhin dhe reputacionin, të drejtat dhe përgjegjësitë e përbashkëta, asetet dhe pasurinë e saj, ndërsa interesi public nënkupton vlerat themelore të shoqërisë, e rrjedhimisht, në kontekst ligjor nënkupton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, parandalimin e rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë, mbrojtjen e ambientit apo mjedisit ku jeton dhe vepron, mbrojtjen e pronës, afarizmit, tregut të lirë dhe rregulluar, sundimin e ligjit dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit.

Ku duhet të bëhet sinjalizimi?

Sinjalizimi duhet të bëhet tek Zyrtari Përgjegjës për Sinjalizim brenda AFK-së.

Çka nënkupton Zyrtari Përgjegjës për Sinjalizim (ZPS)?

Zyrtar përgjegjës për sinjalizim (ZPS) nënkupton personin e caktuar nga AFK-ja për të pranuar dhe trajtuar rastet e sinjalizuara.

Çka është veprimi I dëmshëm?

Veprim i dëmshëm - çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë I punonjësit të AFK-së që cenon interesin e ligjshëm të sinjalizuesit apo personit të lidhur me sinjalizuesin.

Kush është person i lidhur me sinjalizuesin?

Është personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin.

Cilat janë obligimet dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim (ZPS-së)?

Të veproj me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizimit;

Të ruaj fheshhtësinë apo konfidencialitetin e informatave që lidhen me sinjalizimet;

Të veproj dhe kryej punët në mënyrë të pavarur ndaj qëndrimeve politike apo ndaj çfarëdo ndikimi tjetër të padrejtë që mund të pengojë ushtrimin e detyrave të tij/saj që burojnë nga ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve;

Të evitoj çdo lloj konflikti potencial të interesit, dhe të zbulon menjëherë para autoritetit kompetent, çfarëdo lloj konflikti interesi para fillimit të hetimit administrative të sinjalizimit;

Të ndërmerr të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat në lidhje me njoftimin e zhdukjes, fshehjes, ndryshimit, falsifikimit dhe veprimeve të tjera që kanë për qëllim shkatërrimin e tyre.

Cilat konsiderohen si shkelje qe duhet raportuar apo sinjalizuar?

Shkeljen kur punonjësi I AFK-së ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim të kërkuar ligjor që duhet të përmbushet;

Shkeljen ku nga veprimi ose mosveprimi I ndonjë nga punonjësit e AFK-së, është rrezikuar, është duke u rrezikuar, ose ka gjasa të rrezikohet shëndeti apo siguria e stafit të AFK-së;

Shkeljen ku nga veprimi apo mosveprimi I ndonjë nga punonjësit e AFK-së, janë dëmtuar, janë duke u dëmtuar apo ka gjasa të demtohen mjedisi I punës, zyret dhe asetet e AFK-së;

Shkeljen me të cilën ka ndodhur ose është duke ndodhur keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga ndonjë nga punonjësit në AFK;

Shkeljen ku nga veprimi apo mosveprimi I ndonjë nga punonjësit e AFK-së janë keqpërdorur apo po keqpërdoren paratë ose resurset e AFK-së,

Shkeljen ku ndonjë veprim apo mosveprim nga ndonjë nga punonjësit e AFK-së ose në emër të AFK-së është diskriminues, shtypës, ose përbën keqmenaxhim të rëndë ndaj klientëve, bashkëpunëtorëve të AFK-së, apo në komunitet;

Informacioni që synon të tregojë ndonjë nga çështjet që bien në ndonjë nga shkeljet e mësipërme ka qenë, është ose ka gjasa të jetë fshehur ose shkatërruar qëllimshëm.

A lejohet pengimi i sinjalizimit dhe çfarë pasojash ka ndaj personit që pengon sinjalizimin?

JO nuk lejohet pengimi, prandaj çdo veprim ose mosveprim që synon të pengoj raportimin apo sinjalizimin për shkeljet, është I ndaluar të ndodh dhe konsiderohet dhe trajtohet si i pavlefshëm nëse synon të:

- ndalojë ose kufizojë raportimin apo sinjalizimin në interes të përgjithshëm;
- përjashtojë ose kufizojë zbatimin e politikave për sinjalizim të AFK-së apo dispozitave të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve;
- pengojë një person për të filluar ndonjë procedurë në bazë të ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve;
- pengojë një person të lidhur me sinjalizuesin për të kontribuar në një rast të sinjalizimit

Zyrtari përgjegjës për sinjalizim apo cilido person tjetër në rastet përkatëse që pengon apo tenton të pengoj raportimet apo sinjalizimet për shkeljet e pretenduara, ndiqet penalisht sipas dispozitave penale në fuqi në Kosovë.

Çfarë të drejtash dhe çfarë mbrojtje i takojnë sinjalizuesit?

E drejta e:

- mbrojtjes së identitetit tuaj gjatë procesit të sinjalizimit;
- ruajtjes së fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar;
- mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme.

Këto të drejta si sinjalizues, garantojnë sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesit dhe politikave të AFK-së për sinjalizim, si në periudhat në vijim:

- gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
- pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim të kryerjes normale të detyrave funksionale tuajat në marrëdhënie të punësimit;
- pas përfundimit të marrëdhënies tuaj të punës me AFK-në,
- kur nga rrethana të arsyeshme, ti si sinjalizues ke kërkuar mbrojtjen sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Sinjalizuesi që raporton informata në pajtim me dispozitat e ligjit dhe politikave të AFK-së, nuk mund të jeni subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore.

Sinjalizuesi ka të drejtën e mbrojtjes sipas ligjit, në rastet kur:

- raporton informacion, për shkeljet e ndodhura, të pretenduara apo që pritet të ndodhin;
- me arsye beson se informacioni i raportuar apo i shpalosur është i vërtetë.
- kur sinjalizuesi vërtet dyshon apo pretendon në ndonjë shkelje të dikujt, nuk është i detyruar të provoj domosdosmërisht mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar.

Sinjalizuesi ka mbrojtje të garantuar sipas ligjit që, nuk duhet të paragjykohet edhe nëse kërcënimi apo cenimi i interesit të përgjithshëm që ka dyshuar dhe pretenduar që po ndodh apo që do të ndodh, nuk është materializuar, realizuar apo konkretizuar.

Cilat të drejtash gëzon personi tjetër i lidhur me sinjalizuesin

Personi i lidhur me sinjalizuesin gëzon të njëjtën mbrojtje si sinjalizuesi, nëse personi i tillë provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak të lidhjes së tij me sinjalizuesin.

Personi që provon se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij për shkak se personi që ndërmerr veprimin e dëmshëm beson gabimisht se ai është sinjalizues ose person i lidhur me

të gëzon të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si sinjalizuesi.

Zyrtari përgjegjës gëzon të njëjtën mbrojtje ashtu si sinjalizuesi nëse provohet se veprimi i dëmshëm është ndërmarrë kundër tij në lidhje me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit.

A nënkupton kjo që në kuadër të këtij kanali të sinjalizimit mund të raportohen edhe grindjet mosmarrëveshjet, konfliktet apo marrëdhëniet e prishura ndërpersonale apo ndërkolegiale, apo çështje tjera që ndërlidhen me punësimin?

JO, ky kanal i sinjalizimit nuk duhet të shfrytëzohet për paraqitjen apo raportimin e këtyre veprimeve apo rasteve që kanë të bëjnë me konflikte apo raporte jo normale ndërpersonale apo ndërkolegiale, si dhe çështjet tjera lidhur me ngacmimet, diskriminimet, apo çështje tjera të punësimit, dhe të njëjtat nuk hyjnë në këtë fushëveprim të këtij lloji sinjalizimi dhe si të tilla nëse eventualisht paraqiten nga ndonjë punonjës, ato nuk do të trajtohen nga zyrtari përgjegjës për sinjalizim. Këto lloje të rasteve konfliktuoze apo çështjeve tjera të punësimit, duhet të raportohen tek përgjegjësi i juaj direkt apo tek zyrtaret e departamentit të burimeve njerëzore, dhe të trajtohen përmes mekanizimit të ankesave të të punësuarve dhe në përputhje me Politikën për trajtimin e ankesave të të punësuarve.

A mund të keqpërdoret sinjalizimit, a lejohet të ndodh dhe çfarë pasojash mund të këtë?

Sinjalizuesi nuk do të këtë mbrojtje dhe nuk merret në konsideratë në rastet kur:

- sinjalizimi nuk është kryer për llojet e shkeljeve që cenojnë interesin e përgjithshëm, siç janë listuar tek kategoria e llojeve të shkeljeve që konsiderohen që cenojnë interesin e përgjithshëm;
- Sinjalizimi apo raportimi kryhet në bazë të fakteve, informatave ose dokumenteve
- që sigurohen lidhur me dhënien e ndihmës juridike;
- sinjalizuesi qëllimisht raporton ose sinjalizon informacion që ai ka dijeni ose mund të ketë dijeni se është i rremë/pavërtetë.

Sinjalizuesi qëllimisht sinjalizon raste të fabrikuara ose të sajuara dhe që nuk ekzistojnë në realitet, ndaj punonjësit apo bashkëpunëtorëve të AFK-së, me qëllim të dëmtimit të imazhit, reputacionit, integritetit, dinjitetit dhe profilit të tij/saj.

A mbahen konfidenciale raportimet e sinjalizuara?

PO, zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër i cili pranon apo përpunon raportime të sinjalizuara gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e sinjalizimit, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë brenda ose jashtë institucionit, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveç me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor që lidhet me:

- hetimin efektiv të shkeljeve ligjore;

- parandalimin e rrezikut serioz për sigurinë e shtetit, shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin;
- parandalimin e krimit ose ndjekjen penale;
- domosdoshmërinë e zbulimit në interes publik ose kur një gjë e tillë kërkohet me ligj.

Zyrtari përgjegjës dhe personat tjerë nuk duhet të njoftojnë personin e përmendur në sinjalizim, përveç nëse kërkohet domosdoshmërisht me ligj.

Zyrtari përgjegjës duhet të marrë pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit në rast se i kërkohet të japë të dhëna që mund të zbulojnë identitetin e sinjalizuesit tek një autoritet kompetent për veprime që nuk mund të ndërmerren pa e zbuluar identitetin e sinjalizuesit.

Në rastet kur kërkohet me ligj të zbulohet identiteti i sinjalizuesit, zyrtari përgjegjës njofton sinjalizuesin për këtë fakt para si t'ia zbulojë identitetin.

A mbrohen të dhënat personale të sinjalizuesit apo ato mund të keqpërdoren për qëllime tjera?

Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të personave tjerë të përfshirë në sinjalizim përpunohen vetëm për qëllime të këtij ligji.

Zyrtari përgjegjës dhe çdo person tjetër që merr të dhënat personale të sinjalizuesit sipas këtij ligji duhet t'i përpunojë ato në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nëse gjatë trajtimit të informacionit të parashtruar nga sinjalizuesi, haset në të dhëna personale që nuk janë relevante për rastin që është duke u trajtuar, zyrtari përgjegjës apo autoriteti kompetent nuk mund t'i përpunojë më tutje këto të dhëna dhe njëkohësisht duhet t'i arsyetojë si si ka ardhur deri tek hasja në to.

Si bëhet/realizohet sinjalizimi?

Sinjalizuesi e paraqet informacionin tek zyrtari përgjegjës për sinjalizim.

Informacioni dhe informatat që i paraqet duhet të jenë të kuptueshme dhe duhet të përmbajnë të dhënat e personit ndaj të cilit paraqitet sinjalizimi si dhe faktet nëse i disponon.

Sinjalizimi mund të bëhet përmes:

email-it: afksinjalizimi@afkonline.org ;

deklarimit me shkrim të futur në zarf të mbyllur dhe adresuar për Zyrтарin Përgjegjës;

gojarisht, duke e raportuar tek Zyrtari Përgjegjës; dhe

çfarëdo mjeti tjetër të përshtatshëm të komunikimit.

Kur informatat jepen gojarisht, zyrtari përgjegjës për sinjalizim i përpilon dhe paraqet ato në formën me shkrim dhe pastaj të njëjtën formë e nënshkruan sinjalizuesi dhe zyrtari përgjegjës për sinjalizim.

Si bëhet pranimi dhe evidentimi i sinjalizimit

Pas pranimit të rastit të sinjalizuar nga sinjalizuesi, zyrtari përgjegjës për sinjalizim e evidenton sinjalizimin e pranuar duke e regjistruar në regjistrin përkatës, i cili përmbanë këto të dhëna:

- datën e pranimit;
- emrin dhe mbiemrin e sinjalizuesit;
- të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
- departamentin/degën/ apo institucionin (kur është jashtë stafit të AFK-së) e sinjalizuesit, dhe
- përmbajtjen e shkurtër të informatës (titullin e raportimit të sinjalizimit, p.sh. Keqpërdorim I asetit të AFK-së).

Sinjalizuesit i jepet dëshmi (konfirmim) për sinjalizimin e paraqitur/bërë dhe lista e çdo dokumenti mbështetës të dorëzuar bashkë me të.

Si ndodh procesi I fillimit dhe hetimit/shqyrtimit të rastit të sinjalizuar?

Procedura e trajtimit dhe hetimit administrativ të rastit të sinjalizuar iniciohet apo fillohet nga momenti i raportimit apo sinjalizimit të informacionit nga sinjalizuesi.

Zyrtari përgjegjës për sinjalizim e njofton sinjalizuesin për pranimin ose refuzimin e sinjalizimit brenda afatëve të përcaktuara.

Nga pranimit i sinjalizimit, Zyrtari Përgjegjës brenda afatit të përcaktuar, përgatit një raport lidhur me detajet e sinjalizimit dhe i drejtohet organit vendimmarrës përkatës në AFK (që mund të jetë bordi i drejtorëve, në lidhje me sinjalizimet për anëtarët e menaxhmentin të lartë ose menaxhmenti i lartë, në lidhje me sinjalizimet për të gjithë punonjësit tjerë të AFK-së, me përjashtim të menaxherëve të lartë).

Pas përpilimit të raportit, në kërkesën e tij, zyrtari përgjegjës e jep mendimin e tij lidhur me bazueshmërinë e sinjalizimit, si dhe nëse e sheh të nevojshme, e propozon përfshirjen e zyrtatëve ndihmës relevant për zhvillimin e hetimit.

Brenda afatit të përcaktuar, organi vendimmarrës përkatës jep miratimin ose refuzimin për fillim të hetimit të sinjalizimit.

Pasi që organi vendimmarrës përkatës e jep miratimin, zyrtari përgjegjës e fillon hetimin, ku shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga ju si sinjalizues.

Gjatë fazes së hetimit, zyrtari përgjegjës ndërmerr hapat dhe veprimet sipas obligimeve procedurale prej fillimit deri në mbarim të trajtimit të rastit të sinjalizuar dhe ndërmerr veprime që

hetimin e rastit të sinjalizuar ta përfundoj sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo pas kalimit të afateve të përcaktuara.

Zyrtari Përgjegjës, pas mbledhjes së të gjitha fakteve, provave dhe të gjeturave gjatë fazës së hetimit, kompletton dosjen dhe të njëjtën ia dorëzon Organit Vendimmarrës përkatës, i cili brenda afatit të përcaktuar, shqyrton të gjeturat e zyrtarit përgjegjës.

Nëse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje ligjore, Organi Vendimmarrës përkatës autorizon autoritetin kompetent brenda AFK-së për fillimin e procedurave disiplinore, dhe/apo njofton Institucionet kompetente në rastet kur veprimet apo mosveprimet janë të asaj natyre që është e domosdoshme të raportohet tek Institucionet kompetente.

Procedura e hetimit të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që është e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se afati I përcaktuar nga data e pranimit të sinjalizimit. Në rastet kur nga rrethanat e rastit nevojitet shtyrja e afatit, procedura mund të zgjatet dhe të përfundoj në një afat shtesë nga data e pranimit të sinjalizimit.

Pas përfundimit të procedurës së hetimit, Zyrtari Përgjegjës njofton Sinjalizuesin lidhur me përfundimin e procedurës

Në cilat raste mund të bëhet sinjalizim tek Menaxhmenti i Lartë, Drejtori Ekzekutiv apo Bordi i Drejtorëve dhe jo tek zyrtari përgjegjës për sinjalizim?

Përrjashtimisht sinjalizuesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë kryetarit dhe/ose anëtarëve të bordit të drejtorëve të punëdhënësit, rastet kur:

- sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit (të jetë vet subject sinjalizimi apo kryerësi I shkeljes);
- sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person që është ose mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin (dyshon që zyrtari përgjegjës ka miqësi të afërt me shkelësin dhe kjo mund të ndikoj që mos të siguroj qasje objektive por subjektive nga zyrtari përgjegjës- pra të jetë joobjektiv);
- ndaj stafit të menaxhmentit të lartë, kur dyshon që zyrtari përgjegjës mund të mos jetë objektiv mund ta relativizoj apo minimizoj rastin e sinjalizuar, ose mund ta kompromentoj procesin rreth rastit të sinjalizuar;
- sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

Rastet dhe situatat e sinjalizimeve/raportimeve të tilla tek anëtarët e Menaxhmentit të Lartë, Drejtori Ekzekutiv apo Bordit të Drejtorëve, mund të bëhen përmes **email-adresës në email-adresat e tyre zyrtare personale, apo përmes telefonit në numrat e tyre zyrtar personal**, në mënyrë që të ruhet konfidencialiteti dhe të mos ekspozohet dhe zbulohet identiteti I sinjalizuesit

tek zyrtari përgjegjës, që po bëhet raportim sinjalizues kundër tij (kjo kuptohet që vlen për rastet kur sinjalizuesi dëshiron të jetë anonim për zyrtarin përgjegjës).

A ka mbrojtje sinjalizuesi nga veprimet e dëmshme që mund t'i pësoj për sinjalizimet e bërë?

Po, sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm që mund të ndërmerret ndaj tij nga AFK-ja për shkak të sinjalizimit në pajtim me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- shkarkimin nga puna;
- pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- transferimin brenda ose jashtë institucionit pa pëlqimin e tij;
- uljen në pozitë (degradimin në pozitë);
- zvogëlimin e pagës;
- humbjen e statusit dhe privilegjeve;
- mosngritjen në pozitë pengimin në avancim;
- heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- vlerësime negative në marrëdhënien e punës (evaluim negativ /të disfavorshëm);
- anulimin e një licence ose leje;
- përfundimin e një kontrate për mallra apo shërbime;
- veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.

Çdo veprim i dëmshëm ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm dhe sinjalizuesi në cilësinë e të punësuarit, i cili u është nënshtruar veprimeve të dëmshme në vendin e punës, ka të drejtë që t'i drejtohet gjykatës kompetente për realizimin e të mbrojtjes dhe të drejtave si sinjalizues.

Dëmshpërblimi I takon sinjalizuesit në rast të ushtrimit të veprimeve të dëmshme ndaj tij

Çdo person i cili mund të ketë pësuar veprim të dëmshëm si pasojë e sinjalizimit, ka të drejtë të kërkoj në gjykatën kompetente shpërblim për dëmin e pësuar nga veprimi i dëmshëm në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Për më shumë, mund t'i referoheni edhe akteve si vijojnë:

- POLITIKA E AFK-së PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMEVE SI DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE SINJALIZIM dhe
- LIGJIT Nr. 06/L -085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

Kontaktet e Zyrtarit Përgjegjës për Sinjalizim:

e-mail: afksinjalizimi@afkonline.org

mob: +383 49 47 57 55

**Adresa (zyra e zyrtarit përgjegjës) për pranimin e rasteve të sinjalizimit
me zarf përmes postës:**

Sheshi Mujë Krasniqi, Nr. 2, Klinë 32000